



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2814/ 5 prot.

Datë 04.11.2025

V E N D I M
Nr. 1590/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-63205-09-30-2025, me objekt loti 5 “*Blerje mishi dhe nënproduktet e tij*”, me fond limit: 14.432.478,45 (*katërmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë presje dyzet e pesë*) lekë pa TVSH ose 149.065,05 (*njëqind e dyzetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e pesë presje zero pesë*) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 30.09.2025, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Argent Daci*” PF me NIPT L01914003T dhe adresë: Rruga “Abdi Bej Toptani”, Godina Nr. 21, Kthesa Valiasit, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.
Adresa: Lagja “29 Nentori”, Rruga “Kastriot Muço”, Fier.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për*

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.10.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63205-09-30-2025, me objekt loti 5 “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij”, me fond limit: 14.432.478,45 (katërmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë presje dyzet e pesë) lekë pa TVSH ose 149.065,05 (njëqind e dyzetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e pesë presje zero pesë) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 30.09.2025, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.

II.2. Më datë 10.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5922 dhe me nr. 2814/2025 prot., datë 10.10.2025, e operatorit ekonomik “Argent Daci” PF, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi si më poshtë vijon:

Në këtë procedurë prokurimi kërkojmë të behet modifikimi i dokumentave te tenderit dhe konkretisht te kriterit në pikën 2.3.2 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit ku percaktohet se:

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë licencë të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit” ose licencë të kategorisë II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Lidhur me kete kriter te kerkuar ne këte DST ky autoritet kontraktor (Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier) eshte haptazi në shkelle të rekomandimit të APP sipas shkresës nr 6732 datë 21.10.2020 “Rekomandim mbi problemikat e konstatuara gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë dhe shërbime”. Vendosja e nje kriteri te tille duke i barazvleresuar: licencën e kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit, me licencën e kategorisë II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, eshte ne kundërshtim te hapur me Rekomandimin e përbashkët të APP dhe AKU nr 10181 prot, datë 19.11.2018 “Për hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Ne rastin konkret, AK Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier efektivisht duke ekuivalentuar si të njëjta liçencat II.1.A.1 dhe II.1.B, ka vepruar në kundërshtim me rekomandimin e APP dhe me ndryshimet e bëra nuk ka ngjashmëri me asnjë AK tjetër në Shqipëri (Nuk ka asnjë AK që prokuron mish etj. Që ka si kriter për OE që të kenë ose licencë II.1.A.1 ose II.1.B).

Nga sa më sipër del qartë se APP në bazë e zbatim të ligjit ka nxjerrë rekomandim se në procedura kësisoj, OE duhet të paraqesin licencë II.1.A.1. AK në bazë e zbatim të ligjit ka detyrimin që në kryerje të prokurimeve publike të zbatojë ushëzimet e APP, të bashkëpunojë me APP. Nëse ka nevojë për asistencë të komunikojë me APP edhe me email mirëpo në fakt AK ka shkelur rekomandimin e APP.

Padyshim që përgjatë procedurave të prokurimit publik mund të ndodhi që AK për arsye objektive (nevojë për ngritje kapacitetesh, perceptim i gabuar i normave etj) të kryejnë shkelje mirëpo shkelja e kryer në procedurën në fjalë nuk ka asnjë shkak objektiv por

tërësisht subjektiv me qëllimin e paravendosur për të përcaktuar fituesin e garës. Duke qenë se barazimi i vlefshmërisë së licencave II.1.A.1 ose II.1.B është një praktikë e pazbatuar nga ndonjë AK tjetër, atëherë edhe nëse pranojmë që zyrtarët përgjegjës të AK nuk kanë qenë të vëmendshëm ndaj Rekomandimit të përbashkët të APP dhe AKU nr 10181 prot, datë 19.11.2018 për këtë çështje, logjikisht e ligjërish do të duhej që të kishin konkluduar se kanë nevojë për asistencë e komunikim me APP. Ky komunikim është i orientuar si rregull për zbatim në VKM “Për rregullat e prokurimit publik” dhe është parashikuar të kryhet pa asnjë kosto kohore, pasi parashikon që mund të bëhet me email. Nga ana tjetër vecojmë të evidentojmë që APP është tejet aktive në publike të “sjellje në vëmendje” të autoriteteve kontraktore për zbatim të rekomandimeve të nxjerra në vijimësi në bazë të detyrën sipas neni 23 të LPP.

Në të kundërtën me këtë veprim logjik, zyrtarët përgjegjës të AK Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier, kanë trëguar “siguri” në shqyrtimin e kësaj nevojë (barazimin e vlefshmërisë së licencave II.1.A.1 ose II.1.B) që në fakt rezulton shkelje e rekomandimit të APP rekomandim i cili është i përbashkët me institucionin përgjegjës për sigurinë ushqimore sic është AKU.

Duke supozuar për një cast se: Zyrtarët kanë qenë të bindur se perpilimi i DST duke njësuar të njevlershme licencën II.1.A me atë II.1.B është efikase që rrit garën e garanton cilësi e siguri të mallrave objekt prokurimi, për rrjedhojë kanë vepruar me koshiençë që nuk duhet të zbatojnë rekomandimin e APP si dhe të ndryshojnë praktikën e gjithpranuara e zbatuara nga AK e tjera, atëherë këtë inovacion në interpretim e zbatim të ligjit për prokurimin publik kanë patur edhe detyrë ta ndajnë me APP në referencë të neni 74 të VKM nr 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”-i, sipas të cilit: Në kuadër të hartimit të dokumenteve të tenderit, bashkërendimin e punës me APP-në, me qëllim realizimin e kësaj detyre me efikasitet dhe në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi është evidente që zyrtarët e AK kanë vepruar me dashje për shkeljen e këtij rekomandimi, me qëllimin e paracaktuar për të nxjerrë fitues një OE të caktuar.

Ky kriter i kerkuar në kete forme në DST: Jo vetëm që nuk rrit pjesëmarrjen në procedurë prokurimi por përkundrazi e kufizon atë për shkak se ul besimin e OE për pjesëmarrje në garë. Nuk garanton siguri ushqimore për produktet e furnizuara për kategoritë me ndjeshmëri të vecanta të konsumatorëve (që në rastin konkret janë fëmijët e cerdheve dhe kopshteve evidentojmë se sikurse dihet licenca II.1.B është licencë që jepet për cdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes (sqarime më të detajuara lidhur me këtë do përcjellim në vijim) Referuar VKM nr 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” në Aneks 1, Fusha II kategoria II.1 “Prodhimi dhe /ose tregtimi i ushqimeve”, I Nëndarja e kategorisë dhe rregulla të përgjithshme, pika 1 përcaktohet se:

1. Veprimtaria e “Prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH”.

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

Pra cdokush e di që licenca II.1.A është ajo e duhura dhe e domosdoshmja për prokurim publik, sipas të cilit do të shperndahet cdo në mënyrë frekvente (disa ditore) mish në njësitë cerdhe e kopshte ndërsa AK klasifikon si licencë të mjaftueshme edhe ate që është për një vend shitje të përcaktuar (licenca II.1.A parashikon përpunim e shpërndarje, kurse II.1.B parashikon vetëm shitje në një vend të përcaktuar).

Në këto kushte, sic edhe ka ndodhur, ndonëse numri i OE që disponojnë licencë II.1.A është shumë i madh mbi 200 stabilimente thertorte dhe stabilimente përpunimi mishi është fakt që në vijimësi në procedurat kësisoj të organizuara nga AK Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier nuk paraqitet asnjë, pasi janë të bindura se prokurimi kryhet pa integritet. Nga ana tjetër, njësi që kanë objekt veprimtarie që kërkojnë licencë II.1.B janë rreth 1000 mirëpo as prej kësaj kategorie nuk marrin pjesë në prokurime të tilla (përvec disa subjekteve që janë të krijuara e ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e tenderave), pasi janë koshient që nuk përmbushin kriteret për një prokurim të tillë.

Për të dhënat statistikore mbi numrin e operatorëve që ushtrojnë veprimtari që kërkojhet licenca II.1.A dhe II.1.B mund ti referoheni udhëzimit të MBZHR nr 1 datë 15.1.2024 “Për miratimin e planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në pik, për vitin 2024”, në të cilin janë të evidentuara në mënyrë të detajuar të dhëna për numrin e OE për cdo lloj aktiviteti, si dhe numrin e detyrueshëm të kontrolleve zyrtare për secilën kategori OE natyrshëm sic është edhe e pritshme, në këtë udhëzim, përcaktohet se ndaj subjekteve që kryejnë veprimtari prodhim ose përpunim dhe shpërndarje të ushqimeve parashikohen numër më i lartë i kontrolleve, krahasuar me subjektet që kryejnë thjesht shitje në një vend të caktuar të këtyre produkteve.

Referuar VKM nr 538 datë 26.5.2009 ka ndryshim thelbësor në kriteret e posacme të licencimit për OE që licencohen me II.1.A dhe atyre që licencohen me II.1.B. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për cdo stabiliment ku kryhet veprimtaria. 6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në: a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, me kodin II.1.A.1”. 7. Kriteret e posacme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë. Kriteret e posacme mbi cfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posacme llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posacme përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit a) Drejtuesi teknik (sipas specifikimeve) a) certifikatë për drejtuesin teknik b) akte që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit a) standardet tekniko-teknologjike b) higjieno-sanitare (sipas specifikimeve) Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre faktorëve.

11. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.B jepen për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes. 12. Kriteret e posacme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategorinë II.1.B, përcaktohen në tabelën 2 më poshtë. Kriteret e posacme mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posacme llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posacme përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit a) Mjediset b) Teknologjia c) Pajisjet lidhur me standardet tekniko-teknologjike dhe ato higjieno-sanitare (sipas specifikimeve) Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre faktorëve. Sikurse shihet, për rastin e licencës II.1.A kriter licencimi është edhe përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit, - ndërsa në rastin e licencimit me II.1.B nuk ka fare kërkesa të tilla është e qartë se sa garantohet siguria ushqimore e produkteve që furnizohen cerdhet nga një OE që ka personel me njohuri specifike në fushën në fjalë dhe përgjegjësi direkte për zbatimin e tyre dhe një OE tjetër që nuk e di as vetë (nuk ka dijeni profesionale dhe as i kërkohet të ketë) asgjë lidhur me fushën që operon por di vetëm të thotë se aty ku ne e kemi blerë na kanë thenë se është produkti i duhur. Si do ndërveprojnë komisioni i pritjes së mallit të AK me shitësin e produktit bashkëlidhur ju dërgojmë edhe list verifikimin për njësitë e shitjes së mishit të freskët dhe kërkesat e list verifikimin e një stabilimenti ose përpunimi mishi sipas të cilave tregohet qartë garancitë e verifikuara për sigurinë ushqimore për OE që kanë licencë II.1.A dhe atyre II.1.B.

Në rastin konkret, AK Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier, duke konsideruar të njëjtlershme licencën II.1.A me atë II.1.B, efektivisht në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë shkelur kërkesat e kësaj dispozite të LPP (neni 77), pasi sipas tyre OE që do të furnizojë me mish fëmijët e cerdheve nuk ka nevojë që të ketë asnjë aftësi teknike e profesionale (përsërisim se sipas VKM 538 kriteri i vecantë për licencën II.1.B është vetëm për objektin ku kryhet aktiviteti e nuk ka asnjë kërkesë për aftësitë e personelit).

Është evidente që blerja e ushqimeve për fëmijet e kopshteve dhe cerdheve, e sidomos e ushqimeve risikoze sikurse janë ato shtazore, ka një sensitivitet shumë të lartë për verifikimin me rigorozitet të përmbushjes së kriterëve nga operatorët konkurrent lidhur me aftësitë e kapacitetet e tyre (personel, certifikime, makineri pajisje, licenca etj) pasi siguria ushqimore është e para.

Jo më kot referuar ligjit nr 9863/2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar në neni 11 “Përcaktimi i sigurisë ushqimore” pika 1 germa “c” sanksionohet: Pika 1. Germa “a”: për të përcaktuar nëse një ushqim nuk është i sigurt duhen pasur parasysh: a) kushtet normale të përdorimit të ushqimit nga konsumatori dhe çdo fazë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes; Pika 3 germa “c” për të përcaktuar nëse një ushqim nuk është i sigurt duhen pasur parasysh: ndjeshmëritë e vecanta shëndetësore të një kategorie të caktuar konsumatorësh, kur ushqimi është përcaktuar për këtë kategori.

Pikërisht për shkak të kërkesave në rritje që parashikon ligji për ushqimin për sigurinë ushqimore të kategorisë së konsumatorëve në rastin konkret fëmijë, por e njëjta logjikë vlen

edhe për kategoritë e vecanta të sëmureve në spitale etj), të cilët kanë ndjeshmëri të vecanta shëndetësore, APP në bashkëveprim me AKU kanë përcaktuar të detyrueshëm rekomandimin që “Për prokurimet prodhim ose përpunim dhe shpërndarje të ushqimeve për njerëz që në cdo rast AK prokurojnë ushqim për kategori me ndjeshmëri të vecanta konsumatortësh, për fëmijë, për të sëmurë, për azile etj - sanksionohet se OE ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II.1.A.1”. Për këto procedura duhet që personeli që do të realizojë procesin duhet të ketë kualifikim të nevojshëm profesional të vërtetuar me dokumentacion.

Është e qartë që ndjeshmëritë shëndetësore të kategorisë të të miturve të cerdheve e kopshteve janë të vecanta që kërkojnë një nivel më të lartë përkujdesje për ushqim të sigurtë. Nga sa më sipër është evidente që njësimi i vlefshmërisë së liecanecave II.1.A me II.1.B për prokurimin e furnizimit me mish për cerdhet e kopshtet është në shkelje të plotë të kërkesave ligjore. Licenca II.1.B parashikon që subjekti që e posedon është i certifikuar vetëm për ambientet ku do të shesin mish që e ka importuar apo blerë nga një i tretë. Kjo kategori subjektësh nuk është i certifikuar për aftësi të personelit dhe për asnjë manipulim sado të vogël me produktin mish si psh për ta prerë, ndarë mishin nga kockat. Kjo kategori subjektësh nuk është e licencuar për shpërndarje të mishit (vetëm shitje në një vend të caktuar) ndaj nuk ka të drejtë as të transportojë mish. Licenca II.1.A parashikon që: Subjekti ka vec ambienteve edhe personel me dijeni specifike të fushës të cilat janë të certifikuara. Subjekti ka kapacitete për prodhim ose/dhe përpunim (prerje, ndarje të mishit nga kockat, paketim etj) ose/dhe shpërndarje e transport të mishit përderisa sipas VKM 538, nuk ka asnjë kriter për aftësitë e personelit në fushën përkatëse, atëherë i bie që kërkesat e LPP e rregullores së prokurimit publik që, autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; c) aftësinë teknike dhe profesionale atëherë sipas AK Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier, që ka njëhsuar vlefshmerinë e licencës II.1.A me atë II.1.B dmth që AK të përcaktojë kriteret për aftësinë tekniko profesionale të një shitësi të cilat nuk janë të parashikuara në VKM 538.

Per sa me siper subjekti Argent Daci PF kerkon modifikimin e DST te kriterit në pikën 2.3.2 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit si me poshte:

ESHTE

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë licencë të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit” ose licencë të kategorisë II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

TE BEHET

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë licencë të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit” dhe licencë të kategorisë

II.1.B- “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Gjithë ankesa e pasqyruar si më sipër është pjesë e së njëjtës praktike të ngjashme të ndjekur po nga ana jonë kundrejt AK Bashkia Durrës. Komisioni të Prokurimit Publik pas shqyrtimit të ankesës me vendimin Nr. 888/2024 datë 17.07.2024 ka vendosur pranimin e ankese sonë.

II.3. Me shkresën nr. 635/7, datë 14.10.2025, me objekt “Dërgohet vendimi i shqyrtimit të ankesës nga personi përgjegjës i caktuar, në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt Loti 5 Blerje mish dhe nënproduktet e tij me nr REF-63195-09-30-2025” protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 2814/1 prot, datë 15.10.2025, dhe 2814/2 prot, datë 16.10.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar vendimin nr. 635/6 prot, datë 14.10.2025, ku pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka vendosur pranimin pjesërisht si më poshtë vijon:

Per sa me siper pretenduar, sqarojme se:

Nga verifikimi i DST-se, per Lotin 5: Blerje mishi dhe neproduktet e tij, ne shtojcen 8, ne piken 2.3.2 kerkohet:

“Operatori ekonomik pjesemarres, duhet të paragese Licence te kategorise II.1.A.1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, per perpunimin ose tregtimin e produkteve te mishit/ te perpunuara te mishit” ose Licence te kategorise II.1.B “Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)”, te leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i Licences se nje operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018)”.

Referuar Rekomandimit nr. 10181 prot., date 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”. Ne piken III “Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim”, përcaktohet: “Ne hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, autoritetit kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që:

Ne objektet e prokurimit për prodhim/perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez, operatori ekonomik ofertues duhet të disponoj Licence, kategoria, II.1.A.1 “Prodhim, perpunim dhe shperbdarje me shumice e ushqimeve per njerez”, te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit”.

Gjithashtu, referuar edhe vendimit të KPP nr. 888/2024, date 17.07.2024, permendur nga operatori ekonomik ankimues, KPP ka vendosur:

“Komisioni i Prokurimit Publik verën, se objekti i prokurimit të procedurës objekt-ankimi është “Blerje mish viçi, mish pile dhe veze”, dhe autoriteti kontraktor në kriterin e veçante të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomike të paraqesin Licence, “Kategoria:

II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria: II.1.A.1 Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez ose Nënkatëgoria: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez), nderkohe, qe referuar rekomandimit të perbashkët të APP-së dhe AKU-se te dates 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”, eshte percaktuar se në hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim, autoriteti kontraktor duhet te mbaje në konsiderate qe ne objektet e prokurimit per prodhim/perpunim dhe shperndarje me shumice të ushqimeve per njerez, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje Licence, katëgoria II. I.A. 1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, te leshuar nga QKB. Ne kete kontekst kerkesa e autoritetit kontraktor per lejimin e alternatives “ose Nënkatëgoria: II.1.B Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)”, bie ndesh me rekomandimin e APP-se dhe AKU-se, si me sipër cituar”. Nderkohe, operatori ekonomik ankimues, ne ankesë pretendon qe te kerkohen te dyja licencat:

- 1. Licence te katëgorise II.1.A.1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”.*
- 2. Licence te katëgorise II.1.B “Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez), kjo ne kundërshtim me rekomandimin e perbashkët te APP-se dhe AKU-së te dates 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”.*

Per sa me sipër, personi i ngarkuar per shqyrtimin e ankesës gjykon te pranoj pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Argent Daci” PF, duke hequr Licence te katëgorise II.1.B “Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)” nga kriteri 2.3.2 i shtojcës 8 te DST-se, duke lene vetem Licence te katëgorise II.1.A.1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”.

Ne perfundim te shqyrtimit te gjithë dokumentacionit te mesipër, si dhe referuar dispozitave të legjislacionit te posaçëm te prokurimit publik, sipas parashikimit ne nenit 102, pika 1 germa “b” te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit public”, i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesës vendosi te pranoj pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Argent Daci PF, me NUIS L01914003T.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF për modifikimin e kriterëve kualifikuesë me pretendimin se: “Kerkohej modifikimi i DST kriteri në pikën 2.3.2 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit si me poshtë: **ESHTE** 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë licencë të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit” ose licencë të kategorisë II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018). **TE BEHET** 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë licencë të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit” dhe licencë të kategorisë II.1.B- “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018)”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, autoriteti kontraktor, ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **Licencë të kategorisë II.1.A.1** – “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit ose **Licencë të kategorisë II.1.B-** “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

III.1.2. Në “Procesverbalin për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim”, të publikuar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me kriterin e mësipërm është argumentuar si më poshtë vijon:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në pikën 5/a të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Paraqitja e licencës është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përpunim me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes

së konsumatorit. Ky kriter është vendosur me qëllim që ti shërbejë AK për të siguruar për cilësinë e ushqimit për fëmijët e kopshteve dhe çerdheve që janë në kujdesin dhe përgjegjësinë e autoritetit kontraktor.

III.1.3. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF autoriteti kontraktor me shkresën nr. 635/7, datë 14.10.2025, me objekt “Dërgohet vendimi i shqyrtimit të ankesës nga personi përgjegjës i caktuar, në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit publik me objekt Loti 5 Blerje mish dhe nënproduktet e tij me nr REF-63195-09-30-2025” protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 2814/1 prot, datë 15.10.2025, dhe 2814/2 prot, datë 16.10.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar vendimin nr. 635/6 prot, datë 14.10.2025, ku pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka vendosur pranimin pjesërisht si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i DST-se, per Lotin 5: Blerje mishi dhe neproduktet e tij, ne shtojcen 8, ne piken 2.3.2 kerkohet:

“Operatori ekonomik pjesemarres, duhet lë paragese Licence te kategorise II.1.A.1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, per perpunimin ose tregtimin e produkteve te mishit/ te perpunuara te mishit” ose Licence te kategorise II.1.B “Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)”, te leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjeter ekonomik, sipas Rekomandimit te perbashkët te APP-së dhe AKU-së të dates 19.11.2018)”.

Referuar Rekomandimit nr. 10181 prot., date 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”. Ne piken III “Hartimi i kriterëve te veçanta per kualifikim”, percaktohet:

“Ne hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim, autoritetit kontraktor duhet te mbai ne konsiderate që:

Ne objektet e prokurimit per prodhim/perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoj Licence, kategoria, II.1.A.1 “Prodhim, perpunim dhe shperbdarje me shumice e ushqimeve per njerez”, te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit”.

Gjithashtu, referuar edhe vendimit te KPP nr. 888/2024, date 17.07.2024, permendur nga operatori ekonomik ankimues, KPP ka vendosur:

“Komisioni i Prokurimit Publik veren, se objekti i prokurimit të procedures objekt-ankimi është “Blerje mish viçi, mish pule dhe veze”, dhe autoriteti kontraktor ne kriterin e veçante të kualifikimit ka kerkuar nga ana e operatoreve ekonomike të paraqesin Licence, “Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatgoria: II.1.A.1 Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez ose Nënkatgoria: II.I.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez), nderkohe, qe referuar rekomandimit të perbashkët të APP-së dhe AKU-se te dates 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”, eshte percaktuar se në hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim, autoriteti kontraktor duhet te mbaje në konsiderate qe ne objektet e prokurimit per prodhim/perpunim

dhe shperndarje me shumice të ushqimeve per njerez, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje Licence, kategoria II. I.A. 1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, te leshuar nga QKB. Ne kete kontekst kerkesa e autoritetit kontraktor per lejimin e alternatives “ose Nënkatëgoria: II.1.B Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)”, bie ndesh me rekomandimin e APP-se dhe AKU-se, si me sipër cituar”. Nderkohe, operatori ekonomik ankimes, ne ankesë pretendon qe te kerkohen te dyja licencat:

1. Licence te kategorise II.1.A.1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”.

2. Licence te kategorise II.1.B “Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez), kjo ne kundërshtim me rekomandimin e perbashket te APP-se dhe AKU-së te dates 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”.

Per sa me siper, personi i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses gjykon te pranoj pjeserisht ankesën e operatorit ekonomik “Argent Daci” PF, duke hequr Licence te kategorise II.1.B “Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)” nga kriteri 2.3.2 i shtojcës 8 te DST-se, duke lene vetem Licence te kategorise II.1.A.1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”.

Ne perfundim te shqyrtimit te gjithe dokumentacionit te mesiperm, si dhe referuar dispozitave të legjislacionit te posaçem te prokurimit publik, sipas parashikimit ne nenit 102, pika 1 germa “b” te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit public”, i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vendosi te pranoj pjeserisht ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik Argent Daci PF, me NUIS L01914003T.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.5. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është

ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.1.7. Në nenin 77, pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.8. Në nenin 41, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.1.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF si në vijim: “Ku kerkohet modifikimi i DST kriterit në pikën 2.3.2 “Kapaciteti Teknik” të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit si me poshte: **ESHTE** 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë licencë të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit” ose licencë të kategorisë II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018). **TE BEHET** 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë licencë të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit” dhe licencë të kategorisë II.1.B- “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra kombëtare e Biznesit. (Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018)”.”, KPP gjykon, se ky pretendim i ankimuesit në thelb ka të bëjë me shtim të kriteve të kualifikimit dhe jo me pretendime për modifikimin e kriteve diskriminuese, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriteve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”. KPP gjykon, se që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimiteti pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriteve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke u dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurat për fitimin e kontratave publike, do t’i nënshtrohen kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Në rastin konkret, KPP gjykon, se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe

specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kritere kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (*verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji*), por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kriterëve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kritere të reja që do të rëndonin pozitat e operatorëve ekonomik të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (*vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara*) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kriteret e kualifikimit sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (*njësisë së prokurimit*), të shtojë kritere kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Argent Daci” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63205-09-30-2025, me objekt loti 5 “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij”, me fond limit: 14.432.478,45 (*katërmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë presje dyzet e pesë*) lekë pa TVSH ose 149.065,05 (*njëqind e dyzetë*

e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e pesë presje zero pesë) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 30.09.2025, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Argent Daci” PF.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apel.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

